



# Komisioni i Pavarur i Kualifikimit




## **Raport Statistikor** **Shkurt 2018 – Prill 2019**

Komisioni i Pavarur i Kualikimit nga data 8 shkurt 2018 deri në datën 30 prill 2019 ka dhënë 141 vendime.


- 56 vendime për konfirmimin në detyrë të 25 gjyqtarëve, 23 prokurorëve dhe 7 ndihmësve ligjorë/kandidatë për magjistratë;
- 52 vendime për shkarkimin nga detyra të 31 gjyqtarëve, 19 prokurorëve dhe 2 ndihmësve ligjorë/kandidatë për magjistratë;
- 10 vendime për ndërprerjen e procesit të 5 gjyqtarëve, 4 prokurorëve dhe 1 ish-këshilltari ligjor;
- 8 vendime për pushimin e procesit të 3 gjyqtarëve, 1 prokurori dhe 4 ndihmësve ligjorë;
- 15 vendime për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar, për kryeinspektoren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, 10 gjyqtarëve dhe 4 prokurorëve.

Këto vendime pasqyrohen në grafikët e mëposhtëm.

**Grafik 1: Vendimet e KPK-së 8 shkurt 2018 – 30 Prill 2019**




**Grafik 2: Konfirmimet në detyrë në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit**




Komisioni i  
Pavarur i  
Kualifikimit

**Grafik 3: Shkarkimet nga detyra në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit**




Grafik 4: Ndërprerjet e procesit në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës




Komisioni i  
Pavarur i  
Kualifikimit

Grafik 5: Pushimi i procesit sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016




**Grafik 6: Përfundimet e procesit pa një vendim përfundimtar**




Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë 133 vendime me unanimitet, ku të gjithë anëtarët e trupit gjykues kanë votuar në mënyrë të njëjtë dhe 8 vendime me shumicë votash.

**Grafik 7: Vendime me unanimitet dhe shumicë votash**



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë 16 vendime bazuar në një kriter, 10 vendime bazuar në dy kritere dhe 83 bazuar në të tre kriteret e rivlerësimit.

**Grafik 8: Numri i vendimeve sipas kritereve të rivlerësimit**



Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelit pas ankimimit të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Kolegji i Posaçëm i Apelit, deri më 30 prill 2019, ka marrë 22 vendime nga të cilat:

a) 15 lënie në fuqi të vendimeve të Komisionit;


b) 5 ndryshim vendimi, prej të cilave;

2 vendime të ndryshuara pjesërisht (subjektet M. Fana, A. Llalla) dhe 3 vendime të ndryshuara plotësisht (për subjektet B. Dedja, A. Sevdari dhe A. Faqolli) ;

c) 1 prishje të vendimit (për subjektin A. Lazaj) ;

d) 1 pushim të shqyrtimit (për subjektin S. Tola).

**Grafik 9: Vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**



Organet ndihmëse të Komisionit në këtë proces janë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për vlerësimin e pasurisë dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) për vlerësimin e figurës. Vendimmarrja e Komisionit nuk është e kushtëzuar nga përfundimet e rezultateve të këtyre raporteve, pasi Kushtetuta i njeh KPK-së të drejtën e një hetimi të pavarur.


Sipas raporteve të ILDKPKI-së për 108 subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar pa probleme me pasurinë 71 subjekte rivlerësimi dhe me probleme 37 prej tyre, ndërkohë që hetimi i kryer nga Komisioni ka dhënë rezultate të tjera: kanë rezultuar 57 subjekte pa probleme me pasurinë dhe 51 subjekte me probleme.

**Grafik 10: Raporti i ILDKPKI-së dhe rivlerësimi i KPK-së**



Nga raportet e DSIK-së për 92 subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar të papërshtatshëm për vijimin e detyrës 22 subjekte rivlerësimi, ndërkohë që nga hetimi i Komisionit rezultuan me probleme 16 prej tyre.

**Grafik 11: Raporti i DSIK-së dhe kontrolli i figurës i KPK-së**



Pavarur i  
Kualifikimit